

VENDIM
Nr. 639, datë 6.11.2017

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË AGJENCISË SË
AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI
EVROPIAN, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Struktura e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, të jetë gjithsej 21 veta.
4. Vendimi nr. 930, datë 28.12.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2018.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Skema 1

**STRUKTURA E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI
EVROPIAN**



**ORGANIKA E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA
BASHKIMI EVROPIAN**

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I. DREJTOR I PËRGJITHSHËM	II-a	<u>1</u>
II. ZËVENDËSDREJTOR I PËRGJITHSHËM	II-b	<u>1</u>
III. DREJTORIA E AUDITIMIT TË PROGRAMEVE IPA		(7)
DREJTOR	II-b	1
AUDITUES I PARË	II-b	3
AUDITUES I DYTË	III-a	3
IV. DREJTORIA E AUDITIMIT TË PROGRAMIT IPARD		<u>(5)</u>
DREJTOR	II-b	1
AUDITUES I PARË	II-b	2
AUDITUES I DYTË	III-a	2

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
V. DREJTORIA E FINANCËS DHE JURIDIKE		(7)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I FINANCËS DHE ADMINISTRATËS		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST (BUXHET, FINANCË)	IV-a	1
SPECIALIST (BURIME NJERËZORE/ARKIV PROTOKOLL)	IV-a	1
SEKTORI JURIDIK DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST (JURIST)	IV-a	1
SPECIALIST (MARRËDHËNIE ME JASHTË)	IV-a	1
<u>PUNONJËS GJITHSEJ</u>		<u>21</u>

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA